

# Në shkollë për herë të parë.

## Këshilla dhe fakte të dobishme për prindërit dhe fëmijët e tyre parashkollorë

Pas pak kohe, fëmija juaj do të shkojë në shkollë për herë të parë. Është një moment i veçantë, nga i cili mund edhe të lindin disa pyetje. Janë pikërisht ato pyetje të cilave shpreson t'u japë përgjigje broshura Në shkollë për herë të parë: plot me këshilla praktike, histori të vërteta dhe informacione të qarta. Kjo fletëpalosje e përkthyer në gjuhën tuaj do t'ju vijë në ndihmë.



### “Ne kujdesemi mirë për fëmijën tuaj”

**znj. Ellen, mësuese në , Basisschool Klaverdries“, Drongen**

„Së bashku me punonjësen e kujdesit të fëmijës, unë sigurohem që çdo fëmijë të ndihet komod në shkollë dhe të zhvillohet siç duhet. Më duket vetja si një kllloçkë mes zogjve të saj. Gjithashtu, mendoj se një marrëdhënie e mirë me prindërit është e rëndësishme, pasi e bën më të lehtë çdo bisedë. Prandaj është mirë kur prindërit vijnë në klasë pas përfundimit të ditës së shkollës. Fëmijët mund t'ju tregojnë se çfarë kanë bërë. Fytyrat e tyre rrëzëlluese janë diçka magjike.“

### “Shkolla ka një mësuese e posaçme për të ndihmuar me gjuhën”

**Ola Bogdanowicz, nëna e Amelias**

“Amelia do të fillojë shkollën pas 2 muajsh. Ne e vizituam shkollën muajin e kaluar. Mësuesja dhe drejtoresha na u dukën shumë miqësore. Dhe kishte shumë lodra të bukura e të reja: ishte tamam siç i pëlqen Amelias. Në shtëpi ne flasim polonisht. Na ndihmoi prania e miqve flamandë në ditën e vizitës dhe gjatë regjistrimit. Shkolla ka një mësuese të posaçme për të ndihmuar me gjuhën, nëse është e nevojshme.”



## Pesë pyetje nga prindërit

### 1 Fëmija im nuk flet holandisht. A mund ta frekuentojë ai/ajo arsimin parashkollor?

Po, sigurisht. Fëmija juaj do të mësojë shumë shpejt holandisht nëpërmjet lojërave në shkollë. Për fëmijët që e kanë të nevojshme, shumica e shkollave ofrojnë ndihmë shtesë për ta mësuar mirë holandishten.

### 2 Pelenat dhe gjumi i pasdites: a janë këto gjëra të mundshme në shkollë?

Disa klasa parashkollorësh kanë një hapësirë për gjumë, ndërsa të tjerat jo. Më e mira do të ishte që fëmija juaj në fillim të shkojë në shkollë për gjysmë dite. Diskutojini mundësitë me mësuesen. Gjithashtu, duhet të pyesni për masat në lidhje me të mësuarit për të shkuar në tualet. Sido që të jetë, fëmijët që mbajnë ende pelena mund ta frekuntojnë shkollën. Megjithatë, praktikoni në shtëpi me oturakun ose në tualet nëse fëmija juaj është gati.



### 3 Sa kushton arsimi parashkollor?

- Materialet dhe udhëtimet e shkollës të nevojshme për të arritur objektivat për zhvillimin e fëmijës janë pa pagesë.
- Për një vakt të ngrohtë, një pije dhe mbikëqyrje gjatë orës së drekës, shkolla mund të kërkojë një kontribut të arsyeshëm.
  - Po udhëtimet përveç atyre të shkollës apo revistat që duhet të blini? Nuk lejohet që ky lloj shpenzimi të kalojë 45 euro për vit shkollor.
  - Edhe çanta e shkollës dhe këpucët e gjimnastikës do duhet të blihen individualisht.

Familjet me të ardhura të ulëta mund të marrin ndihmë financiare, e cila i nënshtrohet disa kushteve. Kjo quhet bursë shkolle. Ajo arrin vlerën 93,21 euro (për vitin shkollor 2016-2017) për parashkollorët.

#### 4 Cila është mosha më e përshtatshme që fëmija im të fillojë shkollën?

Fëmija juaj mund të fillojë arsimin parashkollor që nga mosha 2 vjeç e gjysmë. Ka data të caktuara fillimi për parashkollorët e rinj: dita e parë e shkollës pas çdo pushimi shkollor, dita e parë e shkollës në shkurt ose dita e parë pas Ditës së Ngjitjes së Krishtit në Qiel.

Si prind, jeni të lirë ta zgjidhni shkollën. Megjithatë, për ta bërë këtë, duhet të ndiqni gjithmonë procedurat e regjistrimit. Ato ndryshojnë nga njëra shkollë në tjetrën dhe nga njëri rajon në tjetrin. Ju rekomandojmë që të interesoheni për këtë kur fëmija juaj të bëhet një vjeç. Për këtë mund t'ju vijë në ndihmë dhe „Kind en Gezin“.

#### 5 Pse është i rëndësishëm arsimit parashkollor për arsimimin e ardhshëm të fëmijës tim?

Mësuesja do ta inkurajojë fëmijën tuaj të eksperimentojë, të ngulmojë dhe të mendojë në mënyrë abstrakte. Si rrjedhojë, fëmija do të gëzojë si kënaqësinë e të mësuarit, ashtu dhe ndjesinë që merret nga të mësuarit diçka. Kjo do ta bëjë më të lehtë të mësuarit në të ardhmen.

Gjuha praktikohet edhe në shkollë: si duhet t'u flisni të rriturve ose fëmijëve të tjerë? Bazat e një gjuhe të pasur e bëjnë më të thjeshtë të menduarit dhe studimin. Nëse fëmija juaj e frekuenton rregullisht arsimin parashkollor, ai ose ajo do të njihet me strukturën e shkollës.



#### Do të dëshironit të mësonit holandisht?

Gjeni një shkollë për arsimimin e të rriturve në lagjen tuaj në [www.huizenvanhetnederlands.be](http://www.huizenvanhetnederlands.be) ose pyesni në shkollën e fëmijës suaj për adresën.



#### Çfarë përshihet tjetër në këtë paketë?

**Një libër historish shkollore.** Si të shkoi dita në shkollë? Për parashkollorët, kjo nuk është një pyetje e lehtë. Pas një dite në shkollë, shikoni ilustrimet në libër. Bëni pyetje në lidhje me aktivitetet e fëmijës suaj në klasë, në këndin e lojërave ose në mensë.

**Etiketat ngjitëse.** A u pastrua mirë fëmija juaj? Ose a mundi ai ose ajo të mos i lagte pantallonat? Shpërblejeni duke i dhënë një etiketë ngjitëse.

**Një libër fillestarësh për prindërit: Në shkollë për herë të parë.** Zbuloni këtu informacione, këshilla dhe histori të tjera.